

GREEN COAST SH.P.K.

RRUGA "TISH DAJA", KOMPLEKSI KIKA 2, GODINA 3, KATI 1., TIRANE, SHQIPËRI

L41329038D

VENDIM

I

ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 27.12.2023, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë **Green Coast Sh.p.k.** (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

- **Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, përfaqësuar rregullisht nga Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. 0342771384 (dhe me nr. Personal: I35203147R), madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (këtu e në vijim referuar si "**Ortaku i Vetëm**"),

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Z. Bers Hado, këshilltar ligjor i shoqërisë, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI DITËS

I. ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se kapitali aktual i Shoqërisë është **4,009,733,328 LEK** (katër miliard e nente milion e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e tre qind e njezet e tetë lekë).

Me qëllim zhvillimin e projekteve MGallery dhe Green Coast Village ka lindur nevoja e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë. Është vlerësuar e përshtatshme **zmadhimi I kapitalit me 500,000,000 LEK (Pesë qind milion lekë)** të cilat do të shpërndahen përkatësisht sipas projekteve :

500,000,000 LEK (Pesë qind milion lekë) per projektin MGallery Hotel

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja

VENDOS:

- A. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë me vlerën 500,000,000 LEK (Pesë qind milion lekë), vlerë e cila do të investohen përkatësisht sipas projekteve :
- vleren 4,846,197 Euro per projektin MGallery**



- B. Bazuar në sa më sipër zmadhimi i kapitalit do të konsiderohet Kontribut ne Para dhe i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga 4,009,733,328 LEK (katër miliard e nentë milion e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e tre qind e njëzet e tetë lekë) do të bëhet 4,509,733,328 LEK (katër miliard e pesë qind nentë milion e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e tre qind e njëzet e tetë lekë).

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Green Coast" sh.p.k mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
GREEN COAST SH.P.K.**

KRYETARI

Edhira MUKA
Znj. Edhira MUKA


SEKRETARI

Z. Bers Hado
Z. Bers Hado